



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË VITISË
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit, Edon Kabashi dhe anëtarët e ekipit Faik Thaqi dhe Imer Vitija nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	19
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	22

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Vitisë për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat financiare vjetore ishin përgatitur në harmoni me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive, dobësi janë vërejtur në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e pasurisë dhe detyrimet.

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak tregon që prej 17 rekomandimeve të dhëna, 10 rekomandime ishin zbatuar dhe katër rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Ndërsa tri rekomandime janë konsideruar të mbyllura.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna e Vitisë. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës dhe Zyrtares Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë, detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

2.1 Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive, dobësi janë vërejtur në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e pasurisë dhe detyrimet.

2.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	11,399,551	11,471,664	11,327,761	99	10,846,811	9,762,874
Granti Qeverisë-Buxheti	10,243,809	10,243,809	10,151,478	99	9,844,173	8,877,644
Të bartura nga viti paraprak ³ -	1,042,973	1,042,973	999,349	96	82,989	166,374
Të hyrat vetjake ⁴	-	105,765	101,676	96	689,683	688,538
Donacionet e brendshme	-	15	-	-	6,644	6,305
Donacionet e jashtme	-	72,790	69,023	95	220,224	24,013
Huamarrja	112,769	6,312	6,236	99	3,098	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 72,113€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 105,765€ dhe rritja nga donacionet për 72,805€, ndërsa kishte zvogëlim të buxhetit nga financimi prej huamarrjes në vlerë 106,457€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 99% të buxhetit final ose 11,327,761€, me përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	11,399,551	11,471,664	11,327,761	99	10,846,811	9,762,874
Pagat dhe Mëditjet	7,363,561	7,366,159	7,295,881	99	7,142,576	6,874,613
Mallrat dhe Shërbimet	1,481,703	1,403,369	1,383,762	99	1,063,318	941,906
Shërbimet komunale	221,000	221,000	220,632	100	198,832	200,580
Subvencionet dhe Transferet	210,000	224,096	211,323	94	260,486	272,706
Investimet Kapitale	2,123,287	2,257,040	2,216,164	98	2,181,599	1,473,069

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Buxheti për mallra dhe shërbime është zvogëluar në vlerë 78,334€ nga të hyrat vetanake të bartura 26,230€, donacionet e jashtme 3,400€ dhe mjetet e financimit nga huamarrja 48,704€.
- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 2,598€ si rezultat i të hyrave të bartura 1,500€, donacionet e jashtme 216€ dhe mjetet e financimit nga huamarrja 882€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 14,096€ nga të hyrat e bartura nga viti paraprak 14,081 dhe donacionet e brendshme 15€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raporte me buxhetin fillestar është rritur për 133,753€, si rezultat i të hyrave të bartura 63,954€ nga viti paraprak, donacionet e jashtme 68,292€ dhe mjetet e financimit nga huamarrja 1,507€.

Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve si rezultat i pagesave nga Thesari

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar përmes vendimeve gjyqësore shpenzime në vlerë 109,221€ nga kategoria joadekuate e shpenzimeve. Prej tyre nga mallra dhe shërbime ishin paguar 22,348€, nga investimet kapitale 60,018€, nga shpenzimet komunale 8,344€ si dhe nga subvencionet dhe transfere 4,122€ për paga jubilarë dhe pagesa pas pensionimit. Gjithashtu nga mallra dhe shërbime kishte paguar vlerën 14,389€ për shpenzime të shpronësimit të cilat i takojnë kategorisë investime kapitale. Kjo kishte ndodhur për shkak se pagesat ishin ekzekutuar direkt nga thesari.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve në Pasqyrat Financiare të Komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2019 ishin në vlerë 941,487€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksa administrative, etj. Gjithashtu komuna kishte edhe të hyra indirekte 199,035€, nga gjobat e gjykatës 11,253€, gjobat e pyjeve 10,000€ dhe dënimet në trafik në vlerë 177,782€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e pranimeve 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	1,042,373	1,042,373	941,487	90	694,570	707,076
Tatimore	400,000	400,000	434,109	109	329,525	292,115
Jo tatimore	642,373	642,373	507,378	79	365,045	414,961

Nga të hyrat vetjake të planifikuara, komuna kishte arritur të arkëtoj 90%, dhe vërehet një trend pozitiv në arkëtimin e të hyrave tatimore nga viti 2018. Kemi testuar 23 mostra për teste substanciale dhe 19 për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Dhënia me qira e pronës komunale pa ju nënshtruar procedurave të duhura

Gjetja Sipas ligjit Nr. 06/L – 092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, neni 8 përcakton se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave të: ankandit publik; shprehjes së interesit; negociatave të Kryetarit të Komunës.

Në një rast për dhënie në shfrytëzim të lokalit me qira, Komuna kishte vazhduar kontratën e skaduar gjatë vitit 2019 edhe për periudhën 2.5 vite duke mos ju përmbajtur kërkesave ligjore për dhënie së pronës komunale me qira. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna për vazhdimin e kontratës ishte thirrur në ligjin për partneritet publiko privat.

Ndikimi Mos respektimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim pronës komunale, i ka pamundësuar komunës që të arrijë çmimin më të lartë për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore.

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 7,366,159€, prej tyre ishin shpenzuar 7,295,881€. Numri i të punësuarve sipas ligjit të buxhetit ishte 1,162, ndërsa numri aktual ishte 1,184. Gjatë vitit 2019 ishin të punësuar pesë punëtor të ri. Kemi testuar 56 mostra për teste substanciale si dhe 23 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallrat dhe shërbime përfshirë komunalitë ishte 1,624,369€, prej tyre në ishin shpenzuar 1,604,394€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, etj. Kemi testuar 39 mostra për teste substanciale në vlerë 238,117€ dhe katër mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 224,096€, prej tyre ishin shpenzuar 211,323€. Shpenzimet kanë të bëjnë me mbështetje financiare të OJQ-ve dhe përfituesve individual. Kemi testuar gjashtë mostra për teste substanciale në vlerë 27,600€ si dhe gjashtë mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.2.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,257,040€, prej tyre ishin shpenzuar 2,216,164€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizim, trotuareve, mirëmbajtje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale. Kemi testuar 54 mostra për teste substanciale në vlerë 980,707€, si dhe tetë mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 81,843,063€, pasurive jokapitale është 244,934€ dhe stoqet 901€ Kemi testuar 58 mostra për teste substanciale në vlerë 990,632€, dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Dobësi në regjistrimin dhe menaxhimin me pasuritë

Gjetja Sipas nenit 7, pika 2 i rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore kërkohet që regjistrimi i transakcioneve në regjistrat përkatës duhet të bazohet në dokumentet burimore origjinale që dëshmojnë se transakcioni ka ndodhur në përputhje me autorizimet përkatëse. Dhe neni 6, pika 5 përcakton se Në raste kur mungojnë informatat financiare nga dhurimi i pasurisë jo financiare, organizata buxhetore do t'i regjistrojë pasuritë në regjistrat e pasurisë në bazë të vlerësimit të bërë nga Komisioni për Vlerësim e Pasurisë jo Financiare. Ky vlerësim duhet të dokumentohet me dëshmi përkatëse.

Pavarësisht rekomandimeve të dhëna në vitet e kaluara, katër shkollat të cilat ishin financuar nga MASHT, të cilat komuna i shfrytëzon nga viti 2012, ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë në mungesë të dokumentacionit përcjellës, vetëm përmes email-ave të dërguar nga ana e zyrtarit të MASHT-it. Edhe përkundër kërkesës së zyrtarit për pasuri për ofrimin e këtij dokumentacioni, MASHT-i ende nuk është përgjigjur pozitivisht dhe komunës nuk i janë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për bartjen e pronësisë.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit për pasurinë e regjistruar, të cilën e shfrytëzon komuna, rezulton me pasiguri për vlerën dhe pronësinë mbi këto pasuri.

Rekomandimi B3 Kryetari të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i, në rastet kur nuk merren informacionet atëherë të bëjë vlerësimin e pasurisë dhe të dokumentohet me dëshmi përkatëse regjistrimi i pasurisë.

2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,075,671€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimin në pronë 1,735,090€, taksa në biznes 314,157€, qiraja 20,139€ dhe të arkëtueshmet tjera 6,285€.

2.5 Detyrimet

2.5.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 371,855€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

Çështja A1 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave

Gjetja Sipas nenit 37.1 të Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcaktohet se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë.

Në pesë raste, pagesat në vlerë 17,549€, faturat e pranuar nuk ishin ekzekutuar brenda afatit prej 30 ditëve. Vonesat ishin nga 11 ditë deri 3 muaj e gjysmë. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë Komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore për Komunën.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.

2.5.2 Detyrimet Kontigjente

Vlera e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 ishte 396,947€. Këto detyrime janë për kontratat/marrëveshjet e nënshkruara për të cilat obligimet paguhen në vitet në vijim.

2.5.3 Detyrimet Kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 120,294€⁵. Këto detyrime janë për kontratat/marrëveshjet e nënshkruara për të cilat obligimet paguhen në vitet në vijim.

⁵ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

2.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy auditorë, ku njëri është Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm. NJAB kishte hartuar planin strategjik për periudhën 2019-2021 dhe planin vjetor për Vitin 2019. Nga shtatë auditimet e planifikuara kishte arritur t'i kryej gjashtë prej tyre. Komiteti i auditimit gjatë vitit 2019 kishte mbajtur tri takime ku janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së për raportet e vitit 2019.

Çështja B4 - Adresimi i ulët i rekomandimeve të NjAB-së

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 5, pika 2.5 Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër të tjera, duhet të ndërmerr veprime për përmirësimin e sistemeve në pajtim me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Në vitin 2019 ishin dhënë gjithsej 22 rekomandimet mirëpo vetëm nëntë janë zbatuar në tërësi, gjashtë ishin në proces të zbatimit, ndërsa shtatë nuk ishin zbatuar. Kjo kishte ndodhur për shkak të angazhimit jo të mjaftueshëm nga menaxhmenti për zbatimin e rekomandimeve.

Ndikimi Mos zbatimi i rekomandimeve nga menaxhmenti e zvogëlon efikasitetin e kontroleve të brendshme dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Vitisë ka rezultuar në 17 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna dhe kishte dorëzuar në tetor 2019 raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 10 rekomandime janë zbatuar dhe katër nuk janë adresuar ende. Ndërsa tri rekomandime konsiderohen si të mbyllura.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj se plani i përpilimit të PFV-së për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet të cilat janë cekur në lidhje me pajtueshmërinë e PFV-të, që është bërë analiza për përcaktimin e arsyeve për prezantimin jo të plotë të detyrimeve në PFV-të dhe të sigurojë se janë vendosur proceset efektive për një shpalosje të drejtë në të ardhmen.	Obligimet janë shpalosur saktë në PVF, ndërsa për keq klasifikim të shpenzimit rekomandimi është dhënë në kapitullin 2.2	Rekomandim i mbyllur.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe që gjatë planifikimit të buxhetit duhet ta bëjë vlerësimin e shumave të mundshme të rrjedhës së parasë së gatshme nga kontestet gjyqësore dhe që ato të paguhen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që të shmangët paraqitja e gabuar dhe të mos rrezikohet zbatimi i shpenzimeve tjera të planifikuara.	Edhe këtë vit janë kryer pagesa nga kategori të gabuara. Shih çështjen B1	Rekomandim i pa zbatuar.
3	Të hyrat	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.	Nuk janë aplikuar procedurat e parapara ligjore. Shih çështjen B2	Rekomandim i pazbatuar.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë një kontroll më të lartë në Drejtorinë për Shërbime Publike, në mënyrë që Rregullorja e brendshme për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha të zbatohet në tërësi dhe vendimet të jenë të qarta dhe të sakta.	Janë marrë masa dhe është zbatuar rekomandimi.	Rekomandim i zbatuar.
5	Paga dhe mëditje	Komuna duhet ta bëjë pagesën retroaktive për pagesën e kompensimit të shumave të paguara më pak, për dy zyrtaret e cekura, si dhe me ashpërsimin e masave të kontrollit të brendshëm ta parandalojë përsëritjen e lëshimeve të ngjashme në të ardhmen.	Nuk ka raste të tilla gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
6	Paga dhe mëditje	Kryetari i Komunës duhet që ti përcaktojë përgjegjësitë e atyre të cilët me veprime të veta kanë sjellë komunën në këtë gjendje të pafavorshme, dhe të ndërmerr masat e përshtatshme në pajtim me ligjin. Të forcojë kontrollin e brendshëm, në mënyrë që në të ardhmen të gjitha aktivitetet në lidhje me	Shkolla ka ndërprerë funksionimin gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.

		organizimin, funksionimin dhe financimin e shkollës për të rriturit të përshtaten në plotësi me Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të MASHT-it.		
7	Mallrat dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhen pas zbatimit të procedurave të thjeshtëzuara të punësimit, përmes konkursit publik dhe vetëm në rastet e kërkesave specifike për punë, dhe jo për pozita të rregullta.	Komuna kishte zbatuar procedura të thjeshtëzuara të punësimit.	Rekomandim i zbatuar.
8	Mallrat dhe shërbime	Kryetari të sigurohet se kontrollet e vendosura janë duke funksionuar dhe dëshmitë për funksionin të këtyre kontrolleve të plotësohen sipas afateve të parapara me rregulla.	Nuk ka raste të tilla gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar
9	Mallrat dhe shërbime	Kryeri duhet të sigurohet se furnizimit i paraprin urdhëresa për blerje e cila është e mbuluar me zotim të mjaftueshme të mjeteve, apo mjetet të sigurohen para se të hyhet në obligim kontraktuale.	Nuk ka raste të tilla gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
10	Subvencion e dhe transfere	Kryetari i komunës duhet të sigurojë të gjitha masat në mënyrë që ta forcojë kontrollin e brendshëm të tërë procesit të ndarjes së subvencioneve, duke filluar nga Thirrja Publike, përmes respektimit të Rregullores gjatë aplikimit, emërimit dhe punës së Komisionit, e deri te raportimit, e gjithë kjo me qëllim që subvencionet e ndara ta arrijnë qëllimin e tyre.	Janë ndërmarrë të gjitha masat për forcimin e kontrollit të brendshëm gjatë ndarjes së subvencioneve.	Rekomandim i zbatuar.
11	Subvencion e dhe transfere	Kryetarin e Komunës duhet të vërtetojë arsyet për mosrespektimin e marrëveshjeve të arritura, si dhe mos shpenzimin e mjeteve të destinuara për qëllime për të cilat ishin mbledhur nga participimi i qytetarëve, dhe ta forcojë kontrollin e brendshëm në këtë fushë, në mënyrë që kjo të mos ndodhë në të ardhmen.	Nuk ka raste të tilla gjatë vitit 2019.	Rekomandim i zbatuar.
12	Investime kapitale	Kryetari, duhet të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e Ligjit të ndërtimit, me ç' rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit edhe leja e përdorimit.	Gjatë testimit lëndëve të këtij viti ne nuk kemi hasur raste të tilla. Ky rekomandim ndërlidhet me projektet të cilat kanë përfunduar.	Rekomandim i mbyllur.

13	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të menaxhimit të pasurisë, në këtë rast, në mënyrë që të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i dhe regjistrimit të pasurisë të financuara nga ana e MAPL-ja, në regjistrat e pasurisë së komunës.	Mbetet sfidë sigurimi dokumenteve burimore nga MASHT. Shih çështjen B3	Rekomandim i pazbatuar.
14	Të arkëtueshmët	Kryetari duhet ta fillojë procesin e rishqyrtimit, ku do të analizoheshin të gjitha llogaritë, në kuptimin e vjetërsisë, shumave të rëndësishme, mundësive reale për pagesë dhe zbatimit të masave ligjore për mbledhjen e tyre.	Komuna kishte ndërmarrë veprime konkrete përmes përmbauesve privat për inkasimin e borxheve nga tatimi në pronë.	Rekomandim i zbatuar
15	Obligimet e paguara	Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshëm të kësaj fushe, dhe të bëjë ndarje më të mirë të detyrave ndërmjet të punësuarve, në mënyrë që të vendoset një sistem më efikas i evidentimit të faturave të pranuar dhe të paguara, dhe të cilat do të rezultojnë me informata më të sakta për gjendjen e llogarive të paguara dhe pagimin më të rregullt të borxheve.	Gjatë testeve tona nuk kemi hasur në gabime të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
16	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se, në mënyrë që NjAB të përfshinë sa më shumë që është e mundur, periudhën aktuale me ndihmën e aktiviteteve operative rrjedhëse. Njëkohësisht, duhet të ketë një fokus më të madh i menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve dhe punës më aktive të AB në plotësimin e këtij objekti.	E njëjta gjendje mbetet Shih çështjen B4	Rekomandim i pazbatuar.
17	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, plani i prokurimit, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, të përcaktohet pronësia mbi rreziqet e identifikuar të individëve të caktuar, apo Bordit për menaxhimin e rreziqeve, të cilit do të raportojnë tek Zyrtari Kryesor Administrativ, në lidhje me rreziqet, përfshirë edhe auditimet e rregullta (tremujore) në mënyrë që të vërtetohet nëse janë ndërmarrë masat ashtu siç ishin planifikuar.	Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e auditimit për vitin 2019 nuk ka trajtuar këtë kapitull.	Rekomandim i mbyllur.

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinin të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se dhënia e pronës komunale në shfrytëzim të kryhet sipas procedurave të parapara ligjore.
3	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari të sigurohet se po ndërmerren hapat konkret për ofrimin e dokumentacionit burimor nga MASHT-i, në rastet kur nuk merren informacionet atëherë të bëjë vlerësimin e pasurisë dhe të dokumentohet me dëshmi përkatëse regjistrimi i pasurisë.
4	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore.
5	Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e Konfirmimit



Komuna e Vitisë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Sokol Haliti

Kryetar i Komunës së Vitisë,

Data: 21.korrik.2020, Viti,